

STATUTI I SHOQERISE  
DHE  
AKTI I THEMELIMIT  
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"Fast & Clean" SH. P. K

Shtetasi Arbër Shkurta , i lindur me 04.09.1988 , ne Tirane, me banim ne Rruga "Lord Bajron" Banes private vila 157 Laprak Tirane , identifikuar me ane te Kartes se identitetit I80904068I, madhor me zotesi te plote per te vepruar, nen cilësinë e ortakut themelues. Shtetsia Ermelinda Arapi , i lindur me 22.04.1984 , ne Çërme Proshkë, me banim ne Rruga Benjamin Kruta",hyrja 1,apa 5,Tiranë, identifikuar me ane te Kartes se identitetit I45422021F, madhor me zotesi te plote per te vepruar, nen cilësinë e ortakut themelues krijojnë:

Sotë me datën 01. Tetori 2020 Arbër Shkurta dhe Ermelinda Arapi krijoji Shoqërinë me përgjegjësi te kufizuar "Fast & Clean" SH. P. K, me seli ne Rruga: Ish Fusha e Aviacionit, Godina 16 hyrja 1. Statuti është akti baze ku do te mbështetet themelimi i shoqërisë tregtare "Fast & Clean" SH. P. K, si dhe zhvillimi i mëtejshëm i saj.

**KREU I**

**NENI 1**

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**1.1** Ortakët e kesaj shoqerie Z. Arbër Shkurta dhe Znj. Ermelinda Arapi jane zoteruesit 100 % te kapitalit te shoqerise. Ne perqindje si me poshte:

1. Arbër Shkurta do te zoterojne 50% te aksjoneve.
2. Ermelinda Arapi do te zoterojne 50% te aksjoneve

**NENI 2**

**EMERTIMI I SHOQERISE**

**2.1.** Shoqeria mban emrin "Fast & Clean" SH. P. K dhe eshte person juridik shqiptar.

**2.2.** Kjo shoqeri e fiton personalitetin e saj juridik me regjistrimin e saj ne Qendren Kombetare te Biznesit.



2.3. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në aktin e themelimit dhe statutit, si dhe në kontratat respektive.

### NENI 3

#### SELIA E SHOQËRISE

3.1. Shoqëria "Fast & Clean" SH. P. K, e ka qendrën e selisë në Rruga Ishe Fushëaviacionit Godina 16 hyrja 1 Tiranë

### NENI 4

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQËRISE

4.1. Objekti i Veprimtarisë Shoqërisë është :

- Import, eksport,
- Pastrim kimik. etj.

4.2. Aktivitetet e sipërpërmendura do të realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar në fuqi dhe në formë me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, të miratuar nga ortakët e saj.

4.3. Shoqëria mund të zgjerojë ose kufizojë fushën e veprimtarisë së saj në çdo kohë.

### NENI 5

#### PERGJEGJESIA E ORTAKUT TE VETEM

5.1. Pjesëmarrja në shoqëri nuk pengon pavarësinë ligjore, organizative dhe të pronësive të ortakut të vetëm.

5.2. Ortakët që marrin pjesë në këtë shoqëri, nuk janë përgjegjës për detyrimet që lindin gjatë aktivitetit tregtar të shoqërisë, të kapitalit themelues të saj, që vetë ai ka nënshkruar, gjithashtu shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet personale të ortakut të saj.

### NENI 6

#### KOHEZGJATJA



6.1. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin ekonomik te saj, per nje periudhe kohe te pakufizuar nga data e regjistrimit te saj.

## NENI 7

### SIMBOLET E SHOQERISE

7.1. Shoqeria do te kete vulen e saj "Fast & Clean" SH. P. K

## KREU II

## NENI 8

### KAPITALI I SHOQERISE

8. Kapitali i shoqerise "Fast & Clean" SH. P. K. eshte 100.000 leke e cili perbehet nga:

8.1. Kapitali para me vlere te barabarte me 100.000 (nje qindemije ) leke

8.2. Shoqeria "Fast & Clean" SH. P. K perbehen nga 2(dy) kuota, me vlere nominale 1 (nje) kote eshte barabarte me 50.000 (njeqindemije) leke.

8.3. Ortaket pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

## NENI 9

### TRANSFERIMI I KAPITALIT DHE I KUOTAVE

9.1. Kapitali themeltar ose pjese te vecanta te tij, jane te transferueshme nga ortaku tek te treset. Transferimi i kapitalit apo pjeseve te tij nga Ortaku ne favor te treteve, kryhet gjithnje me akt noterial te posacem.

9.2. Shoqeria mund te rrisi kapitalin themeltar ose mund ta zvogeloje ate, por gjithnje jo nen kufirin e 100.000 (nje qindmije) leke. Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit behet me vendim te ortakve te shoqerise dhe sipas parashikimeve te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

9.3. Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshrimeve te pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne shërbime, nepermjet emërimit te një eksperti te autorizuar për këto kontribute ne natyre sipas kërkesës së administratorit.

 3

**9.4.** Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortaket e shoqërisë në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

**9.5.** Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

## NENI 10

### TRANSFERIMI I KUOTAVE

**10.1.** Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

**10.2.** Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

**10.3.** Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

## KREU III

### NENI 11

#### ORGANI VENDIMMARRËS

**11.1.** Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

**11.2.** Ortaket, vendin për çështje si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresisë së veprimtarisë;



- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve;
- g) ndryshimin e statutit, e selisë së shoqërisë, hapjen dhe mbylljen e filialeve të saj.
- h) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.

**11.3.** Të gjitha vendimet e marra nga Ortaket e shoqërisë duhet të regjistrohen në regjistrin e vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

**11.4.** Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

**11.5.** Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## NENI 12

### ADMINISTRATORI

**12.1.** Administratori i shoqërisë mund të caktohet edhe një person tjetër, jashtë orokëve.

**12.2.** Administrator i shoqërisë vendose z. Arbër Shkurta

**12.3.** Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 4 vjeçar me të drejta ripërtëritje bazuar në nenin 95/1 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

## NENI 13

### KOMPETENCAT DHE PERGJEGJESITË E ADMINISTRATORIT

**13.1.** Administratori ka të drejtë e detyrohet të:



a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ai vete.

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Ortakut të Vetëm shoqërisë në mbledhjen e asamblesë së ortakeve.

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

**12.1** Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.

**12.2.** Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve.

**12.3.** Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

## **NENI 14**

### **VITI FINANCIAR**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

## **NENI 15**

### **BILANCI I SHOQËRISË DHE DIVIDENTET**

**15.1.** Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, e përberë nga Ortaket miratojnë bilancin e paraqitur nga

 6

Administratori.

**15.2.** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, e përberë nga Ortaket vendosin rreth shpërndarjes së disidentit, pasi të jete zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

## NENI 16

### MBARIMI I SHOQERISE

**16.1.** Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Ortakeve ;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) Me vendim të gjykatës;

**16.2.** Në këtë rast, Ortaket i Vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese " Shoqëri në likuidim e sipër ".

**16.3.** Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagues, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

**16.4.** Nëse Ortaket e shoqërisë nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

## NENI 17

### TRANSFORMIMI I SHOQERISE

**17.1.** Transformimi i shoqërisë behet me vendim të Ortakeve ose kur ekzistojnë faktorë të jashtëm detyrues ligjore, në këto raste vendimi merret pasi i është paraqitur një raport mbi gjendjen e shoqërisë nga ana e administratorit.

**17.2.** Cdo transformim i bërë në kundërshtim me këtë nen është i pavlefshëm.



## NENI 18



## BAZA LIGJORE

18.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

18.2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të dale në zbatim të tyre në Republikën e Shqipërisë.

### NENI 19

#### MOSMARRËVESHJET

16.1. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të tentohet të zgjidhen me konsensus dhe mirëkuptim.

16.2. Në rast të kundërt, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

### NENI 20

#### DISPOZITA PERFUNDIMTARE

20.1. Ky statut është hartuar me vullnetin e lire dhe të plote të Ortakëve të shoqërisë dhe është nënshkruar prej tyre.

20.2. Ky Statut u redaktua në katër kopje, tre në gjuhën shqipe. Një kopje mbahet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

**Ortakët Themelues "Fast & Clean" SH. P. K**

Tiranë më 16.10.2020

ARZEN SHKURTIA